

**VENDIM**  
**Nr. 785, datë 12.12.2022**

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 238, DATË 14.4.2021,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË  
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË 3 (TRI)  
OBJEKTEVE NË BASHKINË MIRDITË DHE CAKTIMIN E BASHKISË MIRDITË  
SI NJËSI ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 238, datë 14.4.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Bashkisë Mirditë, për vitin 2022, i transferohet fondi në masën 83 451 289 (tetëdhjetë e tre milionë e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të 3 (tri) objekteve në Bashkinë Mirditë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, të detajuara, si më poshtë vijon:

a) Rikonstruksionin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve Mirditë (ish-kinemaja), në masën 22 108 052 (njëzet e dy milionë e njëqind e tetë mijë e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH;

b) Rikonstruksionin e ish-godinës së Bashkisë Mirditë, në masën 41 655 628 (dyzet e një milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë) lekë pa TVSH;

c) Rikonstruksionin e godinës së Muzeut Historik Mirditë, në masën 19 687 609 (nëntëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntë) lekë pa TVSH.

b) Në pikën 3, fjalët “... sipas pikave 1 dhe 2 ...” zëvendësohen me “... 1, 2 dhe 2.1...”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**